



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.19

Datë 9 mars 2006

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9474 datë 9.2.2006	Për ratifikimin e Konventës kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetësisë “Për kontrollin e duhanit”	599
Ligj nr.9475 datë 9.2.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”	618
Vendim i KM nr.124, datë 2.3.2006	Për disa ndryshime në vendimin nr.337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e komisionit qeveritar për problemet ujore me vendet fqinje”, të ndryshuar	622
Vendim i KM nr.125, datë 2.3.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Këshillit Kombëtar të Ujit”, të ndryshuar	623
Vendim i KM nr.126, datë 2.3.2006	Për disa shtesa në vendimin nr.228, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave “Për rregullimin e veprimtarisë me jashtë të administratës shtetërore”	624
Vendim i KM nr.127, datë 2.3.2006	Për disa shtesa në vendimin nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, të ndryshuar...	624
Vendim i KM nr.129, datë 2.3.2006	Për një shtesë në vendimin nr.205, datë 13.3.1999 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor”, të ndryshuar.....	625

L I G J
Nr. 9474, datë 9.2.2006

PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS KUADËR TË ORGANIZATËS BOTËRORE TË SHËNDETËSISË “PËR KONTROLLIN E DUHANIT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet Konventa Kuadër e Organizatës Botërore të Shëndetësisë “Për kontrollin e duhanit”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4796, datë 9.2.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

Preambula

Palët në këtë Konventë,
të vendosura për t'i dhënë përparësi së drejtës së tyre për të mbrojtur shëndetin publik;
të vetëdijshme se përhapja e epidemisë së duhanit është një problem botëror me pasoja të rënda për shëndetin publik, që kërkon bashkëpunimin më të gjerë të mundshëm ndërkombëtar dhe pjesëmarrjen e të gjitha vendeve në një reagim efektiv, të përshtatshëm dhe gjithëpërfshirës ndërkombëtar;

duke reflektuar shqetësimet e komunitetit ndërkombëtar rreth pasojave shkatërruese shëndetësore, shoqërore, ekonomike dhe mjedisore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit në shkallë botërore;

të shqetësuara thellësisht për rritjen e konsumimit dhe prodhimit të cigareve dhe prodhimeve të tjera të duhanit në shkallë botërore, veçanërisht në vendet e zhvilluara, si dhe rreth ngarkesës që kjo sjell në familje, te njerëzit e varfër dhe në sistemet kombëtare shëndetësore;

të vetëdijshme se faktet shkencore kanë konstatuar qartë se konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit shkaktojnë vdekje, sëmundje dhe paaftësi, dhe se ka një interval kohor midis ekspozimit ndaj duhanit dhe përdorimeve të tjera të prodhimeve të duhanit dhe fillimit të sëmundjeve të shkaktuara nga duhani;

duke qenë gjithashtu në dijeni se cigaret dhe disa produkte të tjera që përmbajnë duhan janë përgatitur në mënyrë të sofistikuar teknologjike, duke krijuar dhe ruajtur varësinë prej tij dhe se shumë nga përbërësit që ata përmbajnë dhe tymi që prodhojnë janë aktivë nga ana farmaceutike, toksike, mutagjene dhe kancerogjene dhe se varësia ndaj duhanit klasifikohet më vete si një çrregullim në klasifikimet kryesore ndërkombëtare të sëmundjeve;

duke pohuar se ka fakte specifike shkencore që ekspozimi që para lindjes ndaj tymit të duhanit shkakton kushte të rënda shëndetësore dhe zhvillimi për fëmijët;

thellësisht të shqetësuara rreth rritjes së frekuencës së tymosjes dhe formave të tjera të konsumimit të duhanit nga fëmijët dhe adoleshentët në shkallë botërore, veçanërisht pirja masive e duhanit tek moshat e reja;

të alarmuara nga rritja e frekuencës së tymosjes dhe formave të tjera të konsumimit të duhanit nga gratë dhe vajzat e reja në tërë botën dhe duke mbajtur në mendje nevojën për pjesëmarrje të plotë të grave në të gjitha nivelet e politikëbërjes dhe zbatimit dhe nevojës për strategji specifike kontrolli gjinore mbi duhanin;

thellësisht të shqetësuara rreth niveleve të larta të tymosjes dhe formave të tjera të konsumimit të duhanit nga popujt indigjenë;

seriozisht të shqetësuara rreth ndikimit të të gjitha formave të reklamimit, promocionit dhe sponsorizimit, të synuara në nxitjen e përdorimit të prodhimeve të duhanit;

të vetëdijshme se nevojitet veprim bashkëpunues për të eliminuar të gjitha format e tregtisë së paligjshme të cigareve dhe prodhimeve të tjera të duhanit, duke përfshirë kontrabandën, prodhimin e paligjshëm dhe falsifikimin;

duke pohuar se kontrolli i duhanit në të gjitha nivelet dhe veçanërisht në vendet e zhvilluara dhe në vendet me ekonomi në tranzicion kërkon burime të mjaftueshme financiare dhe teknike, me nevojën aktuale dhe të synuar për aktivitete të kontrollit të duhanit;

duke njohur nevojën për të zhvilluar mekanizma të përshtatshëm për të adresuar pasojat afatgjata shoqërore dhe ekonomike të strategjive të suksesshme të uljes së kërkesës për duhan;

të ndërgjegjshme për vështirësitë shoqërore dhe ekonomike që mund të gjenerojnë programet e kontrollit të duhanit në planin afatmesëm dhe afatgjatë në disa vende në zhvillim dhe në vendet me ekonomi në tranzicion dhe duke njohur nevojën e tyre për asistencë teknike dhe financiare në kontekstin e strategjive të zhvillimit në plan kombëtar, për një zhvillim të qëndrueshëm;

të ndërgjegjshme për punën e çmuar të bërë nga shumë shtete në lidhje me kontrollin e duhanit dhe duke vlerësuar udhëheqjen e Organizatës Botërore të Shëndetësisë, si dhe përpjekjet e organizatave dhe organeve të tjera të sistemit të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera ndërkombëtare dhe rajonale ndërshtetërore në zhvillimin e masave mbi kontrollin e duhanit;

duke theksuar kontributin e veçantë të organizatave joshtetërore dhe anëtarëve të tjerë të shoqërisë civile që nuk janë të lidhura me industrinë e duhanit, duke përfshirë organet shëndetësore profesionale, gratë, të rinjtë, grupet mjedisore dhe konsumatore dhe institucionet akademike dhe të kujdesit shëndetësor, për përpjekjet e kontrollit të duhanit në rrafsh kombëtar dhe ndërkombëtar dhe rëndësinë jetike të pjesëmarrjes së tyre në përpjekjet kombëtare dhe ndërkombëtare të kontrollit të duhanit;

duke sjellë ndërmend nenin 12 të Konventës ndërkombëtare mbi të drejtat ekonomike, shoqërore dhe kulturore, të miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 16 dhjetor 1966, i cili deklaron se është e drejta e gjithkujt të gëzojë standardin më të lartë të mundshëm të shëndetit fizik dhe mendor;

duke sjellë ndërmend gjithashtu hyrjen e Kartës së Organizatës Botërore të Shëndetësisë, e cila deklaron se gëzimi i standardit më të lartë të mundshëm të shëndetit është një nga të drejtat themelore të çdo qenieje njerëzore pa dallim race, feje, bindjeje politike, ekonomike ose kushti social;

të vendosura për të nxitur masat e kontrollit të duhanit, bazuar në konsideratat aktuale dhe përkatëse shkencore, teknike dhe ekonomike;

duke sjellë ndërmend se Konventa mbi eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit kundër grave, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara në 20 nëntor 1989, parashikon se Shtetet Palë në Konventë njohin të drejtën e fëmijës për të gëzuar standardin më të lartë të mundshëm shëndetësor,

kanë rënë dakord si më poshtë:

PJESA I HYRJA

Neni 1 Përdorimi i termave

Për qëllime të kësaj Konvente:

a) “Tregti e paligjshme” nënkupton çdo praktikë apo sjellje të ndaluar me ligj dhe e cila lidhet me prodhimin, transportin, marrjen, zotërimin, shpërndarjen, shitjen apo blerjen, duke përfshirë çdo praktikë apo sjellje që mendohet të lehtësojë aktivitete të tilla.

b) “Organizata për integrimin ekonomik rajonal” nënkupton një organizatë që është e përbërë nga shtete të ndryshme sovraane dhe ku shtetet anëtare kanë transferuar kompetencat për një numër çështjesh duke përfshirë autoritetin për marrjen e vendimeve detyruese për vendet anëtare për respektimin e këtyre çështjeve.

c) “Reklamim dhe promovim i duhanit” nënkupton çdo formë të komunikimit, rekomandimit ose veprimit tregtar, me qëllimin, pasojën apo pasojën e mundshme që të ndikojë në promovimin e një produkti duhani ose përdorimin e duhanit në mënyrë direkte ose indirekte.

d) “Kontrolli i duhanit” nënkupton një strategji oferte, kërkesë dhe reduktimi të dëmeve, me qëllim përmirësimin e shëndetit të popullsisë, duke eliminuar ose reduktuar konsumimin e prodhimeve të duhanit dhe ekspozimin ndaj tymit të duhanit.

e) “Industri e duhanit” nënkupton prodhuesit e duhanit, shpërndarësit me shumicë dhe importuesit e prodhimeve të duhanit.

f) “Prodhimet e duhanit” nënkupton produkte të prodhuara tërësisht apo pjesërisht nga gjethja e duhanit si lëndë e parë, të prodhuara për t’u përdorur, për t’u tymosur, thithur, përtypur ose nuhatur.

g) “Sponsorizimi i duhanit” nënkupton çdo formë kontributi për një ngjarje, aktivitet ose individ, me qëllimin, pasojën apo pasojën e mundshme që të ndikojë në promovimin e një produkti duhani ose përdorimin e duhanit në mënyrë direkte ose indirekte.

Neni 2 Marrëdhëniet midis kësaj Konvente dhe marrëveshjeve dhe instrumenteve të tjera ligjore

1. Për një mbrojtje më të mirë të shëndetit njerëzor, Palët nxiten të zbatojnë masa përtej atyre që kërkon kjo Konventë dhe protokollet e saj dhe asgjë në këto instrumente nuk do të pengojë një palë të vendosë kërkesa më të forta që janë të pajtueshme me dispozitat e tyre dhe në përputhje me ligjin ndërkombëtar.

2. Dispozitat e Konventës dhe protokolleve të saj nuk do të ndikojnë në asnjë mënyrë të drejtën e Palëve për të hyrë në marrëveshje dypalëshe ose shumëpalëshe, duke përfshirë marrëveshje rajonale ose nënrajonale, për çështje të lidhura me/ose shtesë të Konventës dhe protokolleve të saj, duke siguruar që marrëveshje të tilla janë të pajtueshme me detyrimet e tyre sipas Konventës dhe protokolleve të saj. Palët në fjalë do t’ia komunikojnë këto marrëveshje Konferencës së Palëve përmes Sekretariatit.

PJESA II OBJEKTIVAT, PARIMET DHE DETYRIMET E PËRGJITHSHME

Neni 3 Objektivat

Objekivi i kësaj Konvente dhe protokolleve të saj është mbrojtja e brezave të sotëm dhe të ardhshëm nga pasojat shkatërruese mbi shëndetin, shoqërinë, mjedisin dhe ekonominë, rrjedhojë e

konsumit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit duke parashikuar një strukturë për masat e kontrollit të duhanit që do të zbatohen nga Palët në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, në mënyrë që të reduktohet gradualisht dhe rrënjësisht përparësia e përdorimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit.

Neni 4

Parimet drejtuese

Për arritjen e objektivit të kësaj Konvente dhe protokolleve të saj, si dhe për të zbatuar dispozitat e saj, Palët duhet të udhëhiqen, ndërmjet të tjerash, nga parimet e paraqitura më poshtë:

1. Çdo person duhet të informohet për pasojat shëndetësore, natyrën droguese dhe kërcënimin vdekjeprurës të shfaqur nga konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të tij dhe masa të tjera efektive legislative, ekzekutive dhe administrative në nivelin e duhur qeveritar duhen të merren për të mbrojtur të gjithë personat nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit.

2. Një përkushtim i fuqishëm politik është i nevojshëm për të zhvilluar dhe mbështetur, në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, masa multisektoriale gjithëpërfshirëse dhe përgjigje të koordinuara, duke marrë parasysh:

a) nevojën për të marrë masa për të mbrojtur të gjithë personat nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit;

b) nevojën për të marrë masa për të parandaluar fillimin, për të nxitur dhe mbështetur ndërprerjen dhe për të ulur konsumimin e prodhimeve të duhanit në çdo lloj forme;

c) nevojën për të marrë masa për të nxitur pjesëmarrjen e individëve dhe komuniteteve vendase në zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e programeve të kontrollit të duhanit që janë të përshtatshme me nevojat dhe perspektivat e tyre si nga ana kulturore, dhe ajo shoqërore;

d) nevojën për të marrë masa për të adresuar risqet specifike sipas gjinisë kur zhvillohen strategjitë e kontrollit të duhanit.

3. Bashkëpunimi ndërkombëtar, veçanërisht transferimi i teknologjisë, njohurive dhe asistencës financiare, si dhe ofrimi i njohurive speciale për vendosjen dhe zbatimin e programeve efektive të kontrollit të duhanit, duke marrë në konsideratë kulturën lokale, si dhe faktorët shoqërorë, ekonomikë, politikë dhe ligjorë, është një pjesë e rëndësishme e Konventës.

4. Masat dhe reagimet multisektoriale gjithëpërfshirëse për të reduktuar konsumimin e të gjitha prodhimeve të duhanit në nivele kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare janë një domosdoshmëri për të parandaluar, në përputhje me parimet e shëndetit publik, shfaqjen e sëmundjeve, paaftësive të parakohshme dhe vdekshmërisë si rezultat i konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të tij.

5. Çështjet e lidhura me përgjegjësinë, të vendosura nga secila Palë brenda juridiksionit të vet, janë pjesë e rëndësishme e kontrollit më të gjerë të duhanit.

6. Rëndësia e asistencës teknike dhe financiare për të ndihmuar tranzicionin ekonomik të rritësve dhe punëtorëve të duhanit, mjetet e jetesës e të cilëve janë seriozisht të rrezikuara prej programeve të kontrollit të duhanit në Palët vende në zhvillim, si edhe për Palët me një ekonomi në tranzicion, duhet të pranohet dhe adresohet në kontekstin e strategjive kombëtare të zhvillimit për zhvillimin e qëndrueshëm.

7. Pjesëmarrja e shoqërisë civile është rrënjësore në arritjen e objektivit të Konventës dhe protokolleve të saj.

Neni 5

Detyrime të përgjithshme

1. Çdo Palë do të zhvillojë, do të zbatojë, do të rishikojë dhe do të freskojë periodikisht strategjinë gjithëpërfshirëse kombëtare multisektoriale të kontrollit të duhanit, planet dhe programet e tjera në përputhje me Konventën dhe protokollet në të cilat ajo është Palë.

2. Për realizimin e këtij qëllimi, secila Palë, në përputhje me mundësitë e saj:

a) do të vendosë ose fuqizojë dhe financojë një mekanizëm koordinues kombëtar ose pika fokusimi për kontrollin e duhanit;

b) do të miratojë dhe zbatojë masa efektive legislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masa të tjera dhe do të bashkëpunojë, sipas rastit, me Palët e tjera në zhvillimin e politikave të përshtatshme për parandalimin dhe reduktimin e konsumit të duhanit, dhënie pas nikotinës dhe ekspozimin ndaj tymit të duhanit.

3. Përsa i përket kontrollit të duhanit, në vendosjen dhe zbatimin e politikave të shëndetit publik, Palët do t'i mbrojnë këto politika nga interesat tregtare dhe interesat e tjera të industrisë së duhanit, në përputhje me ligjin kombëtar.

4. Palët do të bashkëpunojnë në formulimin e masave të propozuara, procedurave dhe udhëzimeve për zbatimin e Konventës dhe protokolleve në të cilat ato janë palë.

5. Palët do të bashkëpunojnë, sipas rastit, me organizata kompetente ndërshtetërore ndërkombëtare dhe rajonale dhe me organizma të tjerë për të arritur objektivat e Konventës dhe protokolleve në të cilat ato janë palë.

6. Palët, brenda mjeteve dhe mundësive në dispozicion të tyre, do të bashkëpunojnë për të rritur burimet financiare për zbatimin efektiv të Konventës nëpërmjet mekanizmave financues dypalësh dhe shumëpalësh.

PJESA III MASAT QË LIDHEN ME REDUKTIMIN E KËRKESËS PËR DUHANIN

Neni 6

Masat që lidhen me çmimin dhe taksat për të ulur kërkesën për duhan

1. Palët pranojnë që masat në lidhje me çmimin dhe taksat janë mjete të rëndësishme dhe efektive të reduktimit të konsumit të duhanit nga segmente të ndryshme të popullsisë, veçanërisht nga personat në moshë të re.

2. Pa cenuar të drejtën sovranë të Palëve për të përcaktuar dhe vendosur politikat e tyre të taksave, secila Palë duhet të marrë parasysh objektivat e saj kombëtarë për shëndetin lidhur me kontrollin e duhanit dhe të miratojë dhe të mbajë, sipas rastit, masa të cilat mund të përfshijnë:

a) zbatimin e politikave të taksave dhe, sipas rastit, politikave të çmimeve në prodhimet e duhanit për të kontribuar në objektivat shëndetësorë që kanë për qëllim reduktimin e konsumit të duhanit;

b) ndalimin ose kufizimin, sipas rastit, të shitjes ose importimit prej udhëtarëve ndërkombëtarë të prodhimeve të duhanit pa taksë dhe tarifa.

3. Palët do të sigurojnë nivelin e taksimit për prodhimet e duhanit dhe tendencat në konsumimin e duhanit në raportet e tyre periodike në Konferencën e Palëve, në përputhje me nenin 21.

Neni 7

Masat që nuk lidhen me çmimin për të ulur kërkesën për duhan

Palët pranojnë që masat e përgjithshme që nuk lidhen me çmimin janë një mjet i rëndësishëm dhe efektiv në reduktimin e konsumit të duhanit. Secila Palë do të miratojë dhe zbatojë masa efektive legislative, ekzekutive, administrative ose/dhe masa të tjera të nevojshme për të zbatuar detyrimet në vijim të nenit 9 deri në nenin 13 dhe do të bashkëpunojë, sipas rastit, me të tjerat direkt ose nëpërmjet organizmave kompetentë ndërkombëtarë duke synuar realizimin e tyre. Konferenca e Palëve do të propozojë udhëzimet e duhura për zbatimin e masave të parashikuara në këto nene.

Neni 8

Mbrojtja nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit

1. Palët pranojnë që evidenca shkencore ka përcaktuar qartë që ekspozimi ndaj tymit të duhanit shkakton vdekjen, sëmundje dhe paaftësi.

2. Çdo Palë do të miratojë dhe zbatojë legjislacion në fushat e juridiksionit ekzistues kombëtar, siç përcaktohet nga ligji kombëtar, dhe do të promovojë aktivisht në nivele të tjera juridiksionale miratimin dhe zbatimin e masave efektive legjislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masave të tjera, të ofruara për mbrojtjen nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit në ambientet e brendshme të punës, transportin publik, vendet publike të mbyllura dhe, sipas rastit, vende të tjera publike.

Neni 9

Rregullimi i përmbajtjes së prodhimeve të duhanit

Konferenca e Palëve, në konsultim me organizmat kompetentë ndërkombëtarë, do të propozojë udhëzime për testimin dhe matjen e përmbajtjes dhe emetimit të prodhimeve të duhanit dhe për rregullimin e këtyre përmbajtjeve dhe emetimeve. Çdo Palë, me miratimin prej autoriteteve kombëtare kompetente, do të miratojë dhe zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masa të tjera për testimin dhe matjen, si dhe këtë rregullim.

Neni 10

Rregullimi i publikimit të dëmeve prej prodhimeve të duhanit

Çdo Palë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar, do të miratojë dhe zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masa të tjera për t'u kërkuar prodhuesve dhe importuesve të prodhimeve të duhanit të paraqesin tek autoritetet shtetërore informacionin mbi përmbajtjen dhe lëshimin e prodhimeve. Çdo Palë do të miratojë dhe zbatojë më tej masa efektive për bërjen publike të informacionit mbi përbërësit toksikë të prodhimeve të duhanit dhe emetimeve që ata mund të prodhojnë.

Neni 11

Paketimi dhe etiketimi i prodhimeve të duhanit

1. Çdo Palë, brenda një periudhe prej tre vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë Palë, do të miratojë dhe zbatojë, në përputhje me legjislacionin e vet kombëtar, masa efektive për të siguruar që:

a) paketimi dhe etiketimi i produktit të duhanit nuk promovon një produkt duhani me mjete fallco, mashtruese, zhgënjyese ose që ka të ngjarë të krijojnë përshtypje të gabuara për karakteristikat e tij, efektet shëndetësore, rreziqet dhe/ose dëmtimet, duke përfshirë çdo term, përshkrim, shenjë dalluese, shenjë figurative ose ndonjë shenjë tjetër që në mënyrë direkte ose indirekte krijon një përshtypje fallco që një produkt i veçantë duhani është më pak i dëmshëm se prodhimet e tjera të duhanit. Këto mund të përfshijnë terma si “katran i ulët”, “i lehtë”, “tepër i lehtë” ose “i butë”;

b) çdo njësi pakete dhe paketimi të prodhimeve të duhanit, si dhe çdo paketim dhe etiketim i prodhimeve të tilla duhet të ketë gjithashtu paralajmërime shëndetësore duke përfshirë efektet e dëmshme të përdorimit të duhanit dhe të mund të përfshijë mesazhe të tjera të përshtatshme. Këto mesazhe dhe lajmërime:

- i) do të miratohen nga autoriteti kombëtar kompetent,
- ii) do të qarkullohen,
- iii) do të jenë të gjera, të qarta, të dukshme dhe të lexueshme,

iv) do të zënë 50% ose më shumë e sipërfaqes kryesore të shfaqur, por nuk duhet të jenë më pak se 30% e sipërfaqes kryesore të shfaqur,

v) do të jenë në formë pikturash apo ilustrimesh ose t'i përfshijnë ato.

2. Çdo njësi pakete, paketimi i prodhimeve të duhanit dhe çdo paketim dhe etiketim i jashtëm i prodhimeve të tilla, në vijueshmëri të paralajmërimeve të specifikuar në paragrafin 1(b) të këtij neni, do të përmbajë informacion për përbërësit dhe emetimet e prodhimeve të duhanit të përcaktuara nga autoritetet kombëtare.

3. Çdo Palë do të kërkojë që paralajmërimet dhe tekstet e tjera të informacionit, të specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni, të shfaqen në çdo njësi pakete dhe paketimi të prodhimeve të duhanit dhe në çdo paketim dhe etiketim të jashtëm të prodhimeve të tilla në gjuhën apo gjuhët e saj kryesore.

4. Për qëllime të këtij neni, termi “paketim dhe etiketim i jashtëm” në lidhje me prodhimet e duhanit zbatohet për çdo paketim dhe etiketim të përdorur në shitjen me pakicë të produktit.

Neni 12

Edukimi, komunikimi, trajnimi dhe ndërgjegjësimi i publikut

Çdo Palë do të promovojë dhe forcojë ndërgjegjësimin e publikut, duke përdorur të gjitha mjetet e komunikimit në dispozicion, sipas rastit. Për arritjen e këtij qëllimi, çdo Palë do të miratojë dhe zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive, administrative ose/dhe masa të tjera për të nxitur:

a) akses të plotë për programe efektive dhe gjithëpërfshirëse edukimi dhe informimi publik për risqet shëndetësore duke përfshirë karakteristikat e dhënies pas konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit;

b) ndërgjegjësimin publik mbi risqet shëndetësore të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit, dhe mbi përfitimet e ndërprerjes/lënies të përdorimit të duhanit dhe stilit të jetës pa duhan siç specifikohet në nenin 14.2;

c) akses publik, në përputhje me legjislacionin kombëtar, për një rang të gjerë informacioni mbi industrinë e duhanit në lidhje me objektivin e kësaj Konvente;

d) programe informimi efektive dhe trajnimet e sensibilizimit e duhura për kontrollin e duhanit drejtuar personave të tillë si, punonjësit shëndetësorë, edukuesit, vendimmarrësit, administratorët dhe persona të tjerë që kanë lidhje me të;

e) informimin dhe pjesëmarrjen e agjencive publike e private dhe organizatave joshtetërore që nuk janë futur në industrinë e duhanit në zhvillimin dhe zbatimin e programeve dhe strategjive ndërsektoriale për kontrollin e duhanit;

f) ndërgjegjësimin publik dhe aksesin për informacionin, lidhur me pasojat e pafavorshme shëndetësore, ekonomike dhe mjedisore të prodhimit dhe konsumimit të duhanit.

Neni 13

Reklamimi, promovimi dhe sponsorizimi i duhanit

1. Palët pranojnë që një ndalim i plotë për reklamën, promovimin dhe sponsorizimin do të reduktonte konsumimin e prodhimeve të duhanit.

2. Çdo palë, në përputhje me parimet e saj kushtetuese, do të ndërmarrë një ndalim të plotë të të gjitha reklamave, promovimeve dhe sponsorizimeve të duhanit. Kjo do të përfshijë, subjekt i mjedisit ligjor dhe mjeteve teknike në dispozicion të asaj Pale, një ndalim të plotë për reklamimin përtej kufijve, promovimin dhe sponsorizimin nisur nga territori i saj. Në këtë lidhje, brenda një periudhe prej 5 vjetësh pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për atë Palë, çdo Palë duhet të ndërmarrë masa legjislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masa të tjera dhe të raportojë në përputhje me nenin 21.

3. Një Palë e cila nuk është në gjendje të marrë përsipër një ndalim të plotë për shkak të parimeve të saj kushtetuese, do të zbatojë kufizime në të gjitha reklammat, promovimin dhe sponsorizimin e duhanit.

Kjo do të përfshijë, subjekt i mjedisit ligjor dhe mjeteve teknike në dispozicion të asaj Pale, kufizime ose një ndalim të plotë për reklamën, promovimin dhe sponsorizimin krijuar në territorin e saj me efekt ndërkuftar. Në lidhje me këtë, çdo Palë do të ndërmarrë masat e duhura legislative, ekzekutive, administrative dhe/ose masa të tjera dhe të raportojë në përputhje me nenin 21.

4. Minimalisht, dhe në përputhje me Kushtetutën dhe parimet e veta kushtetuese, çdo Palë:

a) do të ndalojë të gjitha format e reklamimit, promovimit dhe sponsorizimit që promovojnë një produkt duhani me mjete që janë fallco, mashtruese, zhgënjyese ose që ka të ngjarë të krijojnë përshtypje të gabuara për karakteristikat e tij, efektet shëndetësore, rreziqet dhe/ose dëmtimet;

b) do të kërkojë që mesazhet apo paralajmërimet shëndetësore dhe/ose të tjera të shoqërojnë të gjitha reklamat e duhanit, dhe sipas rastit, promovimet dhe sponsorizimet;

c) do të shtrëngojë përdorimin e iniciativave direkte apo indirekte që nxitin blerjen e prodhimeve të duhanit nga publiku;

d) do të kërkojë, në qoftë se nuk ka një ndalim të plotë, deklarimin te autoritetet e duhura shtetërore të shpenzimeve të industrisë së duhanit për reklama, promovim dhe sponsorizim ende jo të ndaluara. Ato autoritete mund të vendosin t'ia bëjnë këto shifra të vlefshme, subjekt i legjislacionit kombëtar, publikut dhe Konferencës së Palëve, në vijim të nenit 21;

e) do të marrë përsipër një ndalim të plotë ose, në rastin e një Pale, e cila nuk është në gjendje të marrë përsipër një ndalim të plotë për shkak të parimeve të saj kushtetuese, të kufizojë reklamën, promovimin dhe sponsorizimin e duhanit në radio, televizion, median e shkruar dhe sipas rastit mediat e tjera si interneti brenda një periudhe prej 5 vjetësh;

f) do të ndalojë ose, në rastin e një Pale e cila nuk është në gjendje të ndalojë për shkak të parimeve të saj kushtetuese, të kufizojë sponsorizimin e duhanit nga ngjarjet, aktivitetet dhe/ose pjesëmarrjet ndërkombëtare.

5. Palët nxitin të zbatojnë masat përmes detyrimeve të vendosura në paragrafin 4.

6. Palët do të bashkëpunojnë në zhvillimin e teknologjive dhe masave të tjera të nevojshme për lehtësimin e eliminimit të reklamave kufitare.

7. Palët, të cilat kanë një ndalim për forma të caktuara të reklamës, promovimit dhe sponsorizimit të duhanit, kanë të drejtën sovranë t'i ndalojnë këto forma të reklamës, promovimit dhe sponsorizimit ndërkuftar të duhanit që hyjnë në territorin e tyre dhe për të vendosur penalitete të barabarta si për ato që zbatohen brenda vendit. Ky paragraf nuk do të mbështetet apo miraton ndonjë ndëshkim të veçantë.

8. Palët do të marrin në konsideratë përpunimin e një protokollit për të përcaktuar masat që kërkojnë bashkëpunimin ndërkombëtar për një ndalim të plotë për reklamën, promovimin dhe sponsorizimin ndërkuftar.

Neni 14

Masat që lidhen me reduktimin e kërkesës me objektiv varësinë dhe ndërprerjen e pirjes së duhanit

1. Çdo Palë do të zhvillojë dhe bëjë publike udhëzime të përshtatshme, gjithëpërfshirëse dhe integruese bazuar në evidencat shkencore dhe praktikat më të mira duke marrë në konsideratë rrethanat dhe përparësitë kombëtare dhe do të marrë masa efektive për promovimin e ndalimit të përdorimit të duhanit dhe trajtimeve të përshtatshme për varësinë e duhanit.

2. Për këtë qëllim çdo Palë do të përpiqet që:

a) të përcaktojë dhe zbatojë programe më efektive që synojnë dhe promovojnë ndalimin e përdorimit të duhanit, në vende të tilla, si institucionet edukuese, mjediset e kujdesit shëndetësor dhe mjediset sportive;

b) të përfshijë diagnostifikimin dhe trajtimin e varësisë prej duhanit, krijimin e shërbimeve për lënien e duhanit dhe programeve edukuese, planeve dhe strategjive me pjesëmarrjen e punonjësve shëndetësorë dhe atyre socialë;

c) të krijojë programe në qendrat e kujdesit shëndetësor dhe rehabilitimit për diagnostifikimin, këshillimin, parandalimin dhe trajtimin e varësisë prej duhanit;

d) të bashkëpunojë me palët e tjera për të mundësuar vazhdimësinë e trajtimit të varësisë prej duhanit duke përfshirë prodhimet farmaceutike të përmendura në nenin 22.

PJESA IV MASAT QË LIDHEN ME REDUKTIMIN E OFERTËS PËR DUHAN

Neni 15

Tregtia e paligjshme e prodhimeve të duhanit

1. Palët pranojnë se eliminimi i të gjitha formave të tregtisë së paligjshme të prodhimeve të duhanit, në të cilën përfshihet kontrabanda, prodhimi i paligjshëm dhe falsifikimi, si dhe zhvillimi dhe zbatimi i ligjeve përkatëse kombëtare sipas marrëveshjeve botërore, rajonale dhe nënrajonale, përbëjnë komponentë thelbësorë të kontrollit të duhanit.

2. Secila Palë do të miratojë dhe do të zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive administrative, si dhe masa të tjera për të siguruar që të gjitha njësitë e paketave dhe prodhimet e duhanit të jenë të shënuara për të ndihmuar palët në përcaktimin e origjinës së prodhimeve të duhanit dhe në përputhje me ligjet kombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe ose shumëpalëshe përkatëse të ndihmojnë palët në përcaktimin e pikave të devijimit dhe në monitorimin, dokumentimin dhe kontrollimin e lëvizjeve së prodhimeve të duhanit dhe të gjendjes së tyre ligjore. Përveç kësaj, secila palë:

a) do të kërkojë që njësitë e paketave dhe prodhimet e duhanit, të cilat janë për shitje me pakicë dhe me shumicë në tregun e brendshëm të kenë shënimin: “Shitja e lejuar vetëm në (vendoset emri i vendit, njësisë federative, rajonale apo lokale)” ose do të ketë një shënim tjetër efektiv, i cili do të tregojë destinacionin apo do t’i ndihmojë autoritetet për të përcaktuar nëse produkti është legalisht në shitje në tregun e brendshëm;

b) do të konsiderojë, sipas rastit, zhvillimin e një politike dhe praktike ndjekjeje dhe kontrolluese, e cila do të sigurojë më mirë sistemin e shpërndarjes dhe do të ndihmojë në hetimin e tregtisë së paligjshme.

3. Secila Palë do të kërkojë që informacioni ose shenjat e përcaktuara për paketimin në paragrafin 2 të këtij neni do të paraqiten në një formë të lexueshme dhe/ose do të paraqiten në gjuhën ose gjuhët kryesore të asaj Pale.

4. Me qëllim që të eliminojë tregtinë e paligjshme të prodhimeve të duhanit secila Palë:

a) do të monitorojë dhe do të mbledhë të dhëna për tregtinë ndërkufitare për prodhimet e duhanit duke përfshirë tregtinë e paligjshme të tyre, dhe do të shkëmbejë informacion ndërmjet autoriteteve tatimore, doganore dhe autoriteteve të tjera, sipas rastit, në përputhje me ligjet kombëtare dhe marrëveshjet përkatëse dypalëshe dhe shumëpalëshe;

b) do të miratojë apo fuqizojë legjislacionin me ndëshkimet dhe masat e përshtatshme kundër tregtisë së paligjshme të prodhimeve të duhanit duke përfshirë cigaret e falsifikuara dhe ato të hyra kontrabandë;

c) do të ndërmarrë hapat e përshtatshme për të siguruar që i gjithë malli i konfiskuar, i falsifikuar dhe kontrabandë, si dhe prodhimet e tjera të duhanit, duke përdorur metoda që nuk ndotin mjedisin në përputhje me ligjet në fuqi;

d) do të miratojë dhe do të zbatojë masa për monitorimin, dokumentimin dhe kontrollimin e magazinimit dhe shpërndarjes së prodhimeve të duhanit në mënyrë që ato të mos kalojnë pa paguar taksat përkatëse në juridiksionin e vet;

e) do të miratojë masa të përshtatshme, të cilat lejojnë konfiskimin e të ardhurave nga tregtia e paligjshme e prodhimeve të duhanit.

5. Informacioni i mbledhur, mbështetur në nënparagrafët 4(c) dhe 4(d) të kësaj pike, sipas rastit, do të paraqiten në formë agregate nga Palët në raportet periodike të Konferencës së Palëve në përputhje me nenin 21.

6. Palët, sipas rastit dhe në përputhje me ligjet kombëtare, do të promovojnë bashkëpunimin e agjencive kombëtare me organizatat rajonale dhe ndërkombëtare joshitetërore në fusha që lidhen me investigimin, procedimin dhe gjykimin, me qëllim që të eliminojnë tregëtinë e paligjshme të prodhimeve të duhanit.

7. Secila Palë do të përpiqet që të miratojë dhe të zbatojë masa të mëtejshme, duke përfshirë licencimin, sipas rastit, me qëllim që të kontrollojë dhe të rregullojë prodhimin dhe shpërndarjen e prodhimeve të duhanit për të parandaluar tregëtinë e paligjshme.

Neni 16

Shitjet nga të miturit dhe për të miturit

1. Secila Palë do të miratojë dhe do të zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive, administrative dhe masa të tjera në nivelin e përshtatshëm shtetëror për të ndaluar shitjet e prodhimeve të duhanit personave nën moshën e përcaktuar nga ligji i brendshëm, ligji kombëtar ose nën moshën 18 vjeç. Këto masa mund të përfshijnë:

a) kërkesën që të gjithë shitësit e prodhimeve të duhanit të vendosin një tregues të qartë dhe të rëndësishëm në shitoret e tyre për ndalimin e shitjes së duhanit të miturve dhe, në rast dyshimi, të kërkojnë që çdo blerës i duhanit të japë të dhëna të mjaftueshme se ka arritur moshën ligjore për këtë blerje;

b) ndalimin e shitjes së prodhimeve të duhanit me çdo mënyrë lehtësisht të arritshme për t'u blerë siç janë raftet publike të shitoreve;

c) ndalimin e prodhimit dhe shitjes së ëmbëlsirave, lodrave, vakteve të ndërmjetme, lodrave apo objekteve të tjera, të cilët tërheqin të miturit në formën e prodhimeve të duhanit;

d) sigurimin se makinat e shitjes së duhanit nën juridiksionin e vet nuk janë të disponueshme për të miturit dhe nuk promovojnë shitjen e prodhimeve të duhanit të miturve.

2. Secila Palë do të ndalojë ose do të promovojë ndalimin e shpërndarjes falas të prodhimeve të duhanit publikut dhe veçanërisht të miturve.

3. Secila Palë do të bëjë përpjekje për të ndaluar shitjen e cigareve të hapura apo në paketa të vogla, të cilat rrisin përdorimin e prodhimeve të tilla nga të miturit.

4. Palët pranojnë se me qëllim që të rrisin efektivitetin e tyre, masat për të parandaluar shitjen e prodhimeve të duhanit të miturve duhet, aty ku është e mundur, të zbatohen në përputhje me kërkesat që përmban kjo Konventë.

5. Secila Palë, gjatë depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit, pranimit, miratimit, konfirmimit formal apo aderimit pranë Depozitarit apo në çdo moment të mëpasshëm mund të deklarojë me shkrim përkushtimin e saj me fuqi detyruese për të ndaluar vendosjen e makinave të shitjes së duhanit në territorin nën juridiksionin e vet, ose sipas rastit, një ndalim të plotë të makinave të shitjes së duhanit. Një deklaratë e bërë në përputhje me këtë nen pranë Depozitarit, do t'u përcillet të gjitha Palëve të Konventës për informim Palët, prej vetë Depozitarit.

6. Secila Palë do të miratojë dhe do të zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive administrative, si dhe masa të tjera, ku përfshihet ndëshkimi i shitësve dhe shpërndarësve, me qëllim që të sigurojë pajtimin me detyrimet të cilat përmbahen në paragrafët 1-5 të këtij neni.

7. Secila Palë, sipas rastit, do të miratojë dhe do të zbatojë masa efektive legjislative, ekzekutive, administrative, si dhe masa të tjera për të ndaluar shitjen e duhanit nga persona nën moshën e përcaktuar në ligjin e brendshëm, ligjin kombëtar ose nën moshën tetëmbëdhjetë vjeç.

Neni 17

Sigurimi i mbështetjes për aktivitetet alternative ekonomike të suksesshme

Palët, në bashkëpunim me njëra-tjetrën dhe me organizatat joshitetërore rajonale ose ndërkombëtare, do të promovojnë, sipas rastit, alternativa ekonomike të suksesshme për punëtorët, për rritësit dhe, në raste të caktuara, për shitësit me pakicë të duhanit.

PJESA V
MBROJTJA E MJEDISIT

Neni 18
Mbrojtja e mjedisit dhe shëndeti i njerëzve

Gjatë përmbushjes së detyrimeve të kësaj Konvente, Palët bien dakord që të kenë gjithnjë parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetin e personave në lidhje me mjedisin kur trajtohet kultivimi dhe prodhimi i duhanit brenda territoreve të tyre respektive.

PJESA VI
ÇËSHTJET QË KANË TË BËJNË ME PËRGJEGJËSINË DHE DETYRIMET

Neni 19
Përgjegjësia dhe detyrimet

1. Për qëllime të kontrollit të duhanit, palët do të konsiderojnë ndërmarrjen e veprimeve ligjore apo promovimin e ligjeve të tyre ekzistuese, aty ku është e nevojshme, lidhur me përgjegjësinë penale dhe detyrimin civil, përfshirë kompensimet atje ku duhet.

2. Palët do të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën në shkëmbimin e informacionit gjatë Konferencës së Palëve në përputhje me nenin 21 duke përfshirë:

a) informacione mbi efektet shëndetësore prej konsumit të prodhimeve të duhanit, si dhe prej ekspozimit ndaj tymit të duhanit në përputhje me nenin 20, paragrafi 3(a);

b) informacione mbi legjislacionin dhe rregulloret në fuqi si dhe jurisprudencën përkatëse.

3. Palët, sipas rastit dhe pasi kanë rënë dakord në mënyrë të ndërsjellë paraprakisht, brenda kufijve të legjislacionit, politikave dhe praktikave ligjore kombëtare, si dhe të marrëveshjeve në fuqi, do t'i japin njëra-tjetrës mbështetje për procedimet ligjore në lidhje me përgjegjësinë penale dhe detyrimin civil në përputhje me këtë Konventë.

4. Konventa nuk do të ndikojë apo kufizojë në asnjë mënyrë të drejtat apo aksesin e Palëve në gjykatat e njëra-tjetrës aty ku këto të drejta ekzistojnë.

6. Konferenca e Palëve mund të konsiderojë, atje ku është e mundur, në një fazë të hershme, pasi ka marrë në konsideratë punën e bërë në forumet ndërkombëtare, çështje që lidhen me përgjegjësinë përfshi përfaqje relevante ndërkombëtare dhe mjete relevante të ndërmarrja në këtë drejtim dhe, nëse i kërkohet, të mbështesë Palët në aktivitetet e tyre ligjore apo në aktivitete të tjera në përputhje me këtë nen.

PJESA VII
BASHKËPUNIMI TEKNIK E SHKENCOR DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT

Neni 20
Kërkimi shkencor, mbikëqyrja dhe shkëmbimi i informacionit

1. Palët marrin përsipër zhvillimin dhe promovimin e kërkimeve në nivel kombëtar dhe koordinimin e programeve kërkuese në nivel rajonal dhe ndërkombëtar në fushën e kontrollit të duhanit. Për të arritur këtë, secila Palë:

a) do të ndërmarrë iniciativa dhe të bashkëpunojë, drejtpërsëdrejti ose nëpërmjet organizatave ndërshtetërore kompetente në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe organizatave të tjera, kryerjen e vlerësimeve dhe kërkimeve shkencore, duke mundësuar promovimin dhe inkurajimin e kërkimeve që trajtojnë pasojat e pirjes së duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të tij, si dhe kërkimeve për identifikimin e alternativave për mospirjen e tij;

b) do do ndërmarrë promovimin dhe fuqizimin, me mbështetjen e organizatave ndërshtetërore në nivel rajonal dhe ndërkombëtar, si dhe organizatave të tjera e trajnimeve dhe mbështetjes për të gjithë ata persona të përfshirë në aktivitetet për kontrollin e duhanit, duke përfshirë kërkimin shkencor, zbatimin dhe vlerësimin.

2. Palët do të hartojnë, sipas rastit, programe në nivel kombëtar rajonal dhe botëror për mbajtjen nën vëzhgim të kurbës, tipologjisë, përcaktuesve dhe pasojave të pirjes së duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të tij. Për të arritur këtë, Palët do të integrojnë programet e tyre mbikëqyrëse të duhanit në programet kombëtare, rajonale e botërore të mbikëqyrjes së shëndetit, në mënyrë që të dhënat të jenë të krahasueshme dhe të analizueshme në nivel rajonal dhe ndërkombëtar sipas rastit.

3. Palët pranojnë rëndësinë e asistencës teknike dhe financiare nga organizatat ndërqeveritare rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe organizata të tjera. Palët do të përpiqen që:

a) të vendosin në mënyrë progresive një sistem kombëtar për mbikëqyrjen epidemiologjike të pirjes së duhanit dhe të treguesve shëndetësorë, ekonomikë dhe shoqërorë të lidhur me të;

b) të bashkëpunojnë me organizatat ndërshtetërore kompetente rajonale dhe ndërkombëtare dhe organizatat e tjera, përfshirë agjencitë shtetërore apo joshtetërore, për mbikëqyrjen e duhanit në nivel rajonal dhe botëror dhe për shkëmbimin e informacionit mbi treguesit e specifikuar në paragrafin 3(a) në këtë nen:

c) të bashkëpunojnë me Organizatën Botërore të Shëndetësisë për zhvillimin e udhëzimeve apo procedurave të përgjithshme për përcaktimin e mbledhjes, analizimit dhe shpërndarjes së të dhënave pas mbikëqyrjes së konsumimit të duhanit.

4. Palët, subjekt i ligjit kombëtar, do të promovojnë dhe ndihmojnë shkëmbimin e informacionit teknik, shkencor, tregtar e socio-ekonomik, publikisht të disponueshëm, si dhe informacioneve në lidhje me praktikat e industrisë së duhanit dhe kultivimit të tij, në përputhje me këtë Konventë, për të bërë të mundur marrjen në konsideratë dhe adresimin e nevojave specifike të Palëve që janë vende në zhvillim dhe të Palëve me ekonomi në tranzicion. Secila Palë do të përpriqet që:

a) të krijojë dhe të mbajë në mënyrë progresive një bazë të dhënash të freskuara vazhdimisht për ligjet dhe rregullimet ligjore në kontrollin e duhanit, dhe sipas rastit, informacione për zbatimin e tyre dhe jurisprudencën përkatëse, si dhe do të bashkëpunojë në zhvillimin e programeve për kontrollin e duhanit në nivel rajonal dhe botëror;

b) të krijojë dhe të mbajë në mënyrë progresive një bazë të dhënash të freskuara vazhdimisht për programet kombëtare të mbikëqyrjes në përputhje me paragrafin 3(a) të këtij neni;

c) të bashkëpunojë me organizatat kompetente ndërkombëtare për krijimin dhe mbajtjen në mënyrë progresive të një sistemi botëror për rregullimin, mbledhjen dhe shpërndarjen e informacionit mbi prodhimin dhe përpunimin e duhanit dhe aktivitetet e tjera të industrisë së duhanit të cilat kanë pasojë në Konventë apo aktivitetet mbi kontrollin e duhanit në nivel kombëtar;

5. Palët do të bashkëpunojnë me organizatat ndërshtetërore rajonale dhe ndërkombëtare dhe institucionet financiare dhe zhvilluese në të cilat janë anëtare për promovimin dhe inkurajimin e mobilizimit të burimeve teknike dhe financiare për Sekretariatit për të ndihmuar Palët që janë vende në zhvillim dhe Palët që janë me ekonomi në tranzicion që të arrijnë rezultate në kërkime, mbikëqyrje dhe shkëmbim informacioni.

Neni 21

Raportimi dhe shkëmbimi i informacionit

1. Secila Palë do të parashtrojë në Konferencën e Palëve, nëpërmjet Sekretariatit, raporte periodike për zbatimin e kësaj Konvente, të cilat do të përfshijnë si më poshtë:

a) informacionin legjislativ, ekzekutiv, administrativ apo për masat e tjera të marra për zbatimin e Konventës;

b) informacion, sipas rastit, mbi ndonjë vështirësi apo barrierë në zbatimin e Konventës dhe masat e marra për t'i tejkaluar ato;

c) informacion, sipas rastit, mbi asistencën teknike dhe financiare të ofruar apo të marrë në aktivitetet për kontrollin e duhanit;

d) informacion mbi mbikëqyrjen dhe kërkimin shkencor siç specifikohet në nenin 20;

e) informacionin e specifikuar në nenet 6.3,13.2,13.3,13.4 (d),15.5 dhe 19.2.

2. Frekuenca dhe formati i këtyre raporteve nga të gjitha Palët do të përcaktohet nga Konferenca e Palëve. Secila Palë do të përgatisë raportin fillestar brenda dy vjetëve nga hyrja në fuqi e kësaj Konvente për atë Palë.

3. Konferenca e Palëve, në mbështetje të neneve 22 dhe 26, do të konsiderojë përgatitjet për ndihmën ndaj Palëve që janë vende në zhvillim dhe të Palëve me ekonomi në tranzicion, me kërkesën e tyre, për të realizuar detyrimet e tyre sipas këtij neni.

4. Raportimi dhe shkëmbimi i informacionit sipas Konventës në lidhje me konfidencialitetin dhe ruajtjen e sekretit do të jetë subjekt i ligjit kombëtar. Palët do të mbrojnë, në mirëkuptim, të ndërsjellë çdo informacion konfidencial që është shkëmbyer mes tyre.

Neni 22

Bashkëpunimi në fushën shkencore, teknike dhe ligjore, si dhe sigurimi i ekspertizës së nevojshme

1. Palët do të bashkëpunojnë drejtpërsëdrejti apo përmes organizmave kompetentë ndërkombëtarë për fuqizimin e kapaciteteve të tyre në përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga kjo Konventë, duke marrë parasysh nevojat e Palëve që janë vende në zhvillim dhe Palëve me ekonomi në tranzicion. Një bashkëpunim i tillë do të promovojë transferimin e ekspertizës teknike, shkencore dhe ligjore, si dhe të teknologjisë, në mirëkuptim të ndërsjellë, për vendosjen dhe fuqizimin e strategjive, planeve dhe programeve kombëtare për kontrollin e duhanit, që kanë për qëllim ndërmjet të tjerash:

a) ndihmesën në zhvillimin, transferimin dhe marrjen e teknologjisë, njohurive, aftësive, kapaciteteve dhe ekspertizës lidhur me kontrollin e duhanit;

b) sigurimin e ekspertizës ligjore, teknike, shkencore dhe ekspertizave të tjera për vendosjen dhe fuqizimin e strategjive, planeve dhe programeve kombëtare, me qëllim zbatimin e Konventës ndërmjet të tjerash:

i) ndihmës, sipas kërkesës, për zhvillimin e një baze legjislative të fortë, si dhe programeve teknike duke përfshirë ato të parandalimit të fillimit të duhanit, promovimit të ndërprerjes dhe mbrojtjes nga ekspozimi ndaj tymit të duhanit;

ii) ndihmës, sipas kërkesës, për punëtorët e duhanit për zhvillimin e një jetese alternative të përshtatshme ekonomikisht dhe ligjërisht në një mënyrë ekonomike të frytshme;

iii) ndihmës, sipas kërkesës, për rritësit e duhanit për të shkëmbyer prodhimin bujqësor të duhanit me drithëra alternative në një mënyrë ekonomike të frytshme.

c) mbështetjen për programe të përshtatshme trajnimi dhe sensibilizimi për personelin e duhur të siguruar në përputhje me nenin 12;

d) sigurimin, sipas rastit, të materialeve, pajisjeve dhe orendive të nevojshme, si dhe të mbështetjes logjistike për strategjitë, planet dhe programet kombëtare lidhur me kontrollin e duhanit;

e) identifikimin e metodave lidhur me kontrollin e duhanit, duke përfshirë trajtimin e gjithanshëm të varësisë prej nikotinës;

f) promovimin, sipas kërkesës, të kërkimit shkencor për të rritur mundësitë për përballimin e trajtimit të gjithanshëm të varësisë prej nikotinës.

2. Konferenca e Palëve do të promovojë dhe mundësojë transferimin e ekspertizës teknike, shkencore dhe ligjore, si dhe të teknologjisë me mbështetjen financiare të siguruar në përputhje me nenin 26.

PJESA VIII
ORGANIZIMI INSTITUCIONAL DHE BURIMET FINANCIARE

Neni 23
Konferenca e Palëve

1. Një Konferencë e Palëve do të themelohet. Sesioni i parë i Konferencës së Palëve do të mbledhet nga Organizata Botërore e Shëndetësisë jo më vonë se një vit pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente. Pas kësaj në sesionin e parë, Konferenca do të vendosë për vendin dhe kohën e sesioneve të zakonshme të Konferencës së Palëve.

2. Sesionet e jashtëzakonshme të Konferencës së Palëve do të mbahen në çdo kohë që mund të gjykohet e nevojshme nga Konferenca ose nga secila Palë, me kusht që brenda 6 muajve pas komunikimit të kësaj kërkesë me shkrim pranë Sekretariatit të Konventës, ajo të mbështetet nga të paktën një e treta e Palëve.

3. Konferenca e Palëve do të miratojë me konsensus rregullat e procedurës në sesionin e saj të parë.

4. Konferenca e Palëve do të miratojë me konsensus rregullat financiare për vete, për qeverisjen e financimit të çdo organizmi që ajo vetë mund të krijojë, si dhe dispozitat financiare për funksionimin e Sekretariatit. Në çdo sesion do të miratohet buxheti për periudhën financiare deri në sesionin tjetër të radhës.

5. Konferenca e Palëve do të mbajë nën vëzhgim të rregullt zbatimin e Konventës dhe do të marrë vendimet e nevojshme që promovojnë zbatimin efektiv të tyre dhe do të miratojë protokolle, anekse dhe amendamente të Konventës në mbështetje të neneve 28, 29 dhe 33. Për këtë qëllim Konferenca:

a) do të promovojë dhe lehtësojë shkëmbimin e informacionit në përputhje me nenet 20 e 21;

b) do të promovojë dhe ndjekë zhvillimin e metodave krahasuese për studimin dhe mbledhjen e të dhënave, të siguruara në përputhje me nenin 20, që nevojiten për zbatimin e Konventës;

c) do të promovojë zhvillimin, zbatimin dhe vlerësimin e strategjive, planeve dhe programeve ashtu si dhe të politikave, legjislacionit dhe masave të tjera;

d) do të marrë në konsideratë raportet e nënshkruara nga Palët sipas nenit 21 dhe do të miratojë raportet e rregullta në zbatim të Konventës;

e) do të promovojë dhe lehtësojë mobilizimin e burimeve financiare për zbatimin e Konventës në përputhje me nenin 26;

f) do të krijojë organizma të tillë që janë të nevojshëm për të arritur objektivat e Konventës;

g) do të kërkojë, sipas rastit, shërbimet dhe bashkëpunimin, si dhe çdo informacion të siguruar nga organizatat kompetente dhe relevante të Kombeve të Bashkuara dhe organizatave të tjera joqeveritare ndërkombëtare e rajonale që synojnë forcimin e zbatimit të Konventës;

h) do të realizojë veprime të tjera për të arritur objektivin e Konventës në dritën e përvojës së fituar në zbatimin e saj.

6. Konferenca e Palëve do të vendosë kriteret për pjesëmarrjen e vëzhguesve gjatë zhvillimit të sesioneve të saj.

Neni 24
Sekretariati

1. Konferenca e Palëve do të përcaktojë një sekretariat të përhershëm dhe do të përcaktojë dispozitat e duhura për funksionimin e tij. Konferenca e Palëve do të bjerë dakord ta bëjë këtë në sesionin e parë.

2. Deri sa të përcaktohet dhe ngrihet Sekretariati i Përhershëm i Konventës, funksionet e tij do të kryhen nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.

3. Funksionet e Sekretariatit do të jenë:

- a) të bëjë rregullimet për sesionet e Konferencës së Palëve dhe të organizmave të tjerë të lidhur me të dhe t'u sigurojë atyre shërbimet e nevojshme;
- b) të paraqesë raportet e marra prej tij në përputhje me Konventën;
- c) t'u sigurojë mbështetje Palëve, veçanërisht Palëve që janë vende në zhvillim dhe Palëve me ekonomi në tranzicion, në hartimin dhe komunikimin e informacionit në përputhje me dispozitat e Konventës;
- d) të përgatisë raporte për aktivitetet e veta në përputhje me Konventën nën drejtimin e Konferencës së Palëve dhe t'ia parashtrijë ato Konferencës së Palëve;
- e) të sigurojë, nën drejtimin e Konferencës së Palëve, koordinimin e nevojshëm me organizatat ndërkombëtare dhe ndërshtetërore dhe organizma të tjerë;
- f) të hyjë, nën drejtimin e Konferencës së Palëve, në rregullime të tilla administrative ose kontraktuale, siç mund të kërkohet për të realizuar në mënyrë efektive funksionet e veta;
- g) të kryejë funksione të tjera të specifikuar nga Konventa dhe nga ndonjë protokoll i saj, si dhe funksione të tjera siç mund të përcaktohen nga Konferenca e Palëve.

Neni 25

Lidhjet midis Konferencës së Palëve dhe organizatave ndërshtetërore

Me synimin për të siguruar bashkëpunimin teknik dhe financiar për të arritur objektivin e kësaj Konvente, Konferenca e Palëve do të kërkojë bashkëpunimin e organizatave kompetente ndërkombëtare dhe ndërshtetërore duke përfshirë institucionet e financimit dhe zhvillimit.

Neni 26

Burimet financiare

1. Palët pranojnë rolin e madh që kanë burimet financiare në përmbushjen e objektivit të kësaj Konvente.
2. Çdo Palë do të sigurojë mbështetje financiare për aktivitetet kombëtare që synojnë përmbushjen e objektivit të Konventës, sipas planeve, përparësive dhe programeve të tyre kombëtare.
3. Palët do të promovojnë përdorimin e kanaleve dypalëshe, rajonale, nënrajonale dhe shumëpalëshe për të siguruar fondet për zhvillimin dhe forcimin e programeve multisektoriale të kontrollit të duhanit për Palët që janë vende në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion. Në po të njëjtin rrafsh alternativat ekonomikisht të favorshme të prodhimit të duhanit, duke përfshirë diversitetin e bimës do të adresohen dhe do të mbështeten në kontekstin e strategjive kombëtare të zhvillimit.
4. Palët e përfaqësuara në organizatat ndërshtetërore rajonale dhe ndërkombëtare dhe institucionet financiare dhe të zhvillimit do t'i inkurajojnë këto ente për të siguruar asistencën financiare për Palët që janë vende në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion për t'i ndihmuar ato që të përmbushin detyrimet e tyre sipas Konventës, pa kufizuar të drejtat e pjesëmarrjes në këto organizata.
5. Palët do të bien dakord që:
 - a) t'u bëjnë të ditur Palëve në takim detyrimet e tyre sipas Konventës, të gjitha burimet potenciale dhe ekzistuese, financiare dhe teknike të vlefshme për aktivitetet e kontrollit të duhanit.
 - b) Sekretariati do të këshillojë Palët e vendeve në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion për burimet e fondeve për të lehtësuar zbatimin e detyrimeve sipas Konventës.
 - c) Konferenca e Palëve, në sesionin e saj të parë do të shohë burimet ekzistuese dhe potenciale, si dhe mekanizmat e asistencës të bazuara në një studim të kryer nga Sekretariati dhe informacion tjetër relevant dhe të marrë në konsideratë përshtatshmërinë e tyre;
 - d) Rezultatet e këtij rishikimi do të merren në konsideratë nga Konferenca e Palëve për të përcaktuar nevojën e forcimit të mekanizmave ekzistues ose për të përcaktuar një fond botëror vullnetar ose mekanizëm tjetër financiar që të kanalizojë burimet financiare shtesë për Palët e vendeve në zhvillim dhe Palët me ekonomi në tranzicion për t'iu bërë të njohur objektivat e Konventës.

PJESA IX
ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE

Neni 27

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rastin e një debati midis dy ose më shumë Palëve përsa i përket ndërmjet tepetit ose zbatimit të kësaj Konvente, Palët në fjalë duhet të përpiqen me rrugë diplomatike të zgjidhin mosmarrëveshjet nëpërmjet bisedimit ose çdo mënyre tjetër paqësore siç mund të zgjedhin, përfshi politesën, meditim ose pajtimin. Dështimi për të arritur një marrëveshje me politesë, meditim ose pajtim nuk do t'i bëjë Palët në debat të heqin dorë nga gjetja e një zgjidhjeje të pranuar bashkërisht nga të dyja Palët.

2. Kur ratifikon, pranon, miraton, aderon apo konfirmon formalisht Konventën, ose në çdo moment të mëvonshëm, një shtet ose një organizatë e integritit ekonomik rajonal mund të deklarojë me shkrim pranë Depozitarit, se për çdo debat të pazgjidhur në përputhje me paragrafin 1 të këtij neni, ai pranon si të detyrueshëm një arbitrim *ad hoc* në përputhje me procedurat që do të miratohen me konsensus nga Konferenca e Palëve.

3. Dispozitat e këtij neni do të zbatohen edhe në lidhje me çdo protokoll për Palët e atij protokollit, nëse nuk është parashikuar ndryshe në të.

PJESA X
ZHVILLIMI I KONVENTËS

Neni 28

Amendamentet e Konventës

1. Çdo Palë mund të propozojë amendamente të Konventës. Amendamente të tilla do të merren parasysh nga Konferenca e Palëve.

2. Amendamentet e Konventës do të miratohen në mbledhjen e Konferencës së Palëve. Teksti i çdo amendamenti të propozuar do t'u komunikohet Palëve nga Sekretariati të paktën 6 muaj para mbledhjes në të cilën ai propozohet për miratim. Sekretariati do t'u komunikojë gjithashtu amendamentet e propozuara firmëtarëve të Konventës, dhe për informacion, Depozitarit.

3. Palët duhet të bëjnë çdo përpjekje për të arritur marrëveshje me konsensus për amendamentet e propozuara Konventës. Në qoftë se të gjitha përpjekjes për konsensus kanë dështuar dhe asnjë marrëveshje nuk është arritur, amendamenti do të miratohet, si mjet i fundit, me 3/4 e votës së shumicës së Palëve të pranishme që votuan në seancë. Për qëllime të këtij neni, Palë të pranishme dhe votim, do të thonë Palët e pranishme që votojnë pro ose kundër. Çdo amendament i miratuar do t'i komunikohet Depozitarit nga Sekretariati, i cili do t'ua dërgojë atë të gjitha Palëve për miratim.

4. Instrumentet e miratimit në lidhje me një amendament do të depozitohen me Depozitarin. Një amendament i miratuar, në përputhje me paragrafin 3 të këtij neni, do të hyjë në fuqi për Palët që e kanë miratuar në ditën e 90-të pas datës së depozitimit me Depozitarin të instrumenteve të pranimit nga të paktën 2/3 e Palëve të Konventës.

5. Amendamenti do të hyjë në fuqi për çdo Palë tjetër në ditën e 90 pas datës së depozitimit me Depozitarin të instrumentit të pranimit të këtij amendamenti prej asaj Pale.

Neni 29

Miratimi dhe amendimi i shtojcave të Konventës

1. Shtojcat e kësaj Konvente dhe amendamentet e lidhura do të propozohen, miratohen dhe hyjnë në fuqi, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenin 28.

2. Shtojcat në këtë Konventë do të formojnë një pjesë përbërëse dhe, në qoftë se nuk parashikohet ndryshe shprehimisht, një referencë për këtë Konventë përbën në të njëjtën kohë një referencë për çdo shtojcë këtu.

3. Shtojcat do të kufizohen në lista, formularë dhe materiale të tjera përshkuese, lidhur me çështjet procedurale, shkencore, teknike ose administrative.

PJESA XI DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 30 **Rezervat**

Asnjë rezervë nuk mund t'i bëhet kësaj Konvente.

Neni 31 **Tërheqja**

1. Në çdo moment pasi kanë kaluar dy vjet nga data kur Konventa ka hyrë në fuqi për atë Palë, kjo Palë mund të tërhiqet nga Konventa duke njoftuar me shkrim për këtë tërheqje, Depozitarin.

2. Çdo tërheqje e tillë do të hyjë në fuqi pas përfundimit të periudhës njëvjeçare pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë prej Depozitarit ose në një datë të mëvonshme, nëse kjo specifikohet në njoftimin e tërheqjes

3. Çdo Palë që tërhiqet nga Konventa do të konsiderohet se është tërhequr dhe nga çdo protokoll në të cilin ajo është Palë.

Neni 32 **E drejta e votës**

1. Çdo Palë e Konventës do të ketë një votë, me përjashtim të rasteve të parashikuara në paragrafin 2 të këtij neni.

2. Çdo organizatë e integritit ekonomik rajonal, në çështje brenda kompetencave të tyre, do të ketë një numër votash në përputhje me numrin e shteteve anëtare të tyre që janë Palë të Konventës. Kjo organizatë nuk do të ushtrojë të drejtën e votës, nëse një nga shtetet anëtare e ushtron këtë të drejtë individualisht dhe anasjelltas.

Neni 33 **Protokollet**

1. Çdo Palë mund të propozojë protokolle. Protokolle të tilla do të merren parasysh nga Konferenca e Palëve.

2. Konferenca e Palëve mund të miratojë protokolle të kësaj Konvente. Në miratimin e këtyre protokolle do të bëhen të gjitha përpjekjet për të arritur konsensusin. Nëse të gjitha përpjekjet për konsensus dështojnë, protokollin duhet të votohet nga të paktën 3/4 e Palëve të pranishme në seancë. Për qëllime të këtij neni, Palë të pranishme dhe votim, do të thonë Palët e pranishme që votojnë pro ose kundër.

3. Teksti i një protokollin të propozuar do t'u komunikohet Palëve nga Sekretariati të paktën gjashtë muaj para seancës në të cilën propozohet të miratohet.

4. Vetëm Palët e Konventës mund të jenë palë e protokollit.

5. Çdo protokoll i Konventës do të jetë i detyrueshëm vetëm për Palët në protokollin në fjalë. Vetëm Palët në këtë protokoll mund të marrin vendime për çështjet që lidhen ekskluzivisht me protokollin në fjalë.

6. Mënyra ligjore e hyrjes në fuqi të një protokollin do të përcaktohet në po atë instrument.

Neni 34
Nënshkrimi

Kjo Konventë do të hapet për nënshkrim për të gjithë anëtarët e Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe çdo shtet tjetër që nuk është anëtar i Organizatës Botërore të Shëndetësisë, por është anëtar i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, si dhe për të gjitha organizatat e integritit ekonomik rajonal, në selinë e OBSH-së në Gjenevë në periudhën 16 qershor 2003 deri më 22 korrik 2003, dhe më pas në selinë e Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, në periudhën 30 qershor 2003 deri në 29 qershor 2004.

Neni 35
Ratifikimi, pranimi, miratimi, konfirmimi formal ose aderimi

1. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit nga shtetet dhe konfirmimit formal nga organizatat e integritit ekonomik rajonal. Ajo do të hapet për pranim një ditë pas nënshkrimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, miratimit, aderimit apo konfirmimit formal do të depozitohen pranë Depozitarit.

2. Çdo organizatë e integritit ekonomik rajonal që bëhet Palë e Konventës në rastin kur asnjë vend anëtar nuk është Palë në Konventë, do t'u nënshtrohet drejtpërsëdrejti detyrimeve të kësaj Konvente. Në rastin kur një ose më shumë vende anëtare të këtyre organizatave janë Palë të Konventës, organizata dhe vendet anëtare respektive do të vendosin për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të mbartjes së përgjegjësive që kjo Konventë u jep Palëve. Në raste të tilla, shtetet anëtare të këtyre organizatave nuk do të mund t'i ushtrojnë këto të drejta individualisht.

3. Çdo organizatë e integritit ekonomik rajonal, gjatë depozitimit të instrumentit përkatës të ratifikimit, pranimit, miratimit, konfirmimit formal apo aderimit pranë Depozitarit, duhet të deklarojë shtrirjen e kompetencave të tyre sipas Konventës. Këto organizata do të informojnë gjithashtu Depozitarin, i cili do t'i informojë Palët, për çdo modifikim thelbësor në shtrirjen e kompetencave të tyre.

Neni 36
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e 90-të duke filluar nga data në të cilën është depozituar instrumenti i 40-të i ratifikimit, pranimit, miratimit, konfirmimit formal apo aderimit pranë Depozitarit.

2. Për çdo shtet që ratifikon, miraton, pranon apo aderon në këtë Konventë, pasi janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për hyrjen në fuqi të Konventës, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e 90-të duke filluar nga data në të cilën është depozituar instrumenti përkatës i konfirmimit formal apo aderimit.

3. Për çdo organizatë rajonale të integritit ekonomik që depoziton instrumentin përkatës të konfirmimit formal apo aderimit, pasi janë përmbushur kushtet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni për hyrjen në fuqi të Konventës, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e 90-të duke filluar nga data në të cilën është depozituar instrumenti përkatës i konfirmimit formal apo aderimit.

4. Për qëllime të këtij neni, çdo instrument i depozituar nga një organizatë rajonale e integritit ekonomik nuk do të llogaritet si shtesë e instrumenteve të depozituara prej secilit vend anëtar i kësaj organizate.

Neni 37
Depozitari

Depozitari i kësaj Konvente, si dhe i amendamenteve, protokolleve dhe shtojcave të miratuara në përputhje me nenin 28, nenin 29 dhe nenin 33 do të jetë Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara.

Neni 38
Tekstet autentike

Kjo Konventë, tekstet e së cilës në gjuhët angleze, arabe, kineze, spanjolle, frënge dhe ruse janë njëloj të besueshme, do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Në dëshmi të sa më sipër, firmëtarët, të autorizuar posaçërisht për këtë qëllim kanë firmosur këtë Konventë.

Bërë në Gjenevë, më 21 maj 2003.

Shtojca 1: WHA 56.1 Konventa kuadër e OBSH-së për kontrollin e duhanit

Asambleja e 56-të e Shëndetit Botëror,

duke sjellë ndërmend rezolutat WHA 49.17 dhe WHA 52.18 që kërkon zhvillimin e një konvente në kuadër të Organizatës Botërore të Shëndetit mbi kontrollin e duhanit, në përputhje me nenin 19 të Kushtetutës së Organizatës Botërore të Shëndetit:

e vendosur për të mbrojtur brezat e tanishëm dhe të ardhshëm nga konsumimi i duhanit dhe ekspozimi ndaj tymit të duhanit;

duke vërejtur me shqetësim të thellë rritjen e pirjes së duhanit dhe formave të tjera të përdorimit të tij në shkallë botërore;

duke vlerësuar raportin e kryetarit të Organit Negociues Ndërqeveritar mbi rezultatin e punës së Organit Negociues Ndërqeveritar;

e bindur se kjo Konventë është një hap i ri në avancimin e masave kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare dhe bashkëpunimit global për të mbrojtur shëndetin human kundër ndikimit shkatërrues të konsumimit të duhanit dhe ekspozimit ndaj tymit të duhanit dhe të ndërgjegjshëm se duhet t'i jepet vëmendje prioritare situatës së veçantë të shteteve të zhvilluara dhe vendeve me ekonomi në tranzicion;

duke theksuar nevojën për hyrjen e menjëhershme në fuqi dhe zbatimin efektiv të Konventës:

1. Miraton Konventën e bashkëngjitur kësaj rezolute;
2. Vëren, në përputhje me nenin 34 të Konventës, se Konventa do të jetë e hapur për nënshkrim në mjediset e Organizatës Botërore të Shëndetit në Gjenevë nga 16 qershori 2003 deri në 22 qershor 2003 dhe më pas në selinë e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork, nga 30 qershori 2003 deri në 29 qershor 2004;
3. Urdhëron të gjitha shtetet dhe organizatat e integritit ekonomik rajonal të autorizuar ta bëjnë këtë, të marrin në konsideratë nënshkrimin, ratifikimin, pranimin, miratimin, konfirmimin formal ose pranimin e Konventës në mundësinë më të parë, me qëllim ardhjen e Konventës në fuqi sa më parë që të jetë e mundur;
4. Nxit të gjitha shtetet dhe organizatat e integritit ekonomik rajonal, në pritje të hyrjes në fuqi të Konventës, të marrin të gjitha masat e duhura për të ulur konsumimin e duhanit dhe ekspozimin ndaj tymit të duhanit;
5. Nxit të gjitha shtetet anëtare, organizatat e integritit ekonomik rajonal, vëzhguesit dhe palët e tjera të interesuara të mbështesin aktivitetet përgatitore të parashtruara në këtë rezolutë dhe të inkurajojnë efektivisht hyrjen e menjëhershme në fuqi dhe zbatimin e Konventës;
6. Urdhëron Kombet e Bashkuara dhe fton organizatat e tjera përkatëse ndërkombëtare të vazhdojnë të sigurojnë mbështetje për forcimin e programeve kombëtare dhe ndërkombëtare të kontrollit të duhanit;
7. Vendosi të krijojë, në përputhje me rregullin 42 të Rregullave të Procedurës së Asamblesë së Shëndetit Botëror, një grup pune ndërqeveritar të pakufizuar që do të jetë i hapur për të gjitha shtetet dhe organizatat e integritit ekonomik rajonal të parashtruara në nenin 34 të Konventës, me qëllim konsiderimin dhe përgatitjen e propozimeve në ato çështje të identifikuara në Konventë për konsideratë dhe miratim, siç duhet, nga seksioni i parë i Konferencës së Palëve, këto çështje duhet të përfshijnë:

1) rregullat e procedurës për Konferencën e Palëve (neni 23.3), duke përfshirë kriteret për pjesëmarrjen e vëzhguesve në sesionet e Konferencës së Palëve (neni 23.6);

2) opsionet për emërimin e një sekretariati të përhershëm dhe përgatitjet për funksionimin e tij (neni 24.1);

3) rregullat financiare për Konferencën e Palëve dhe organet e saj ndihmëse; dhe masat financiare që udhëheqin funksionimin e sekretariatit (neni 23.4);

4) një draftbuxhet për periudhën e parë financiare (neni 23.4);

5) një rishikim i burimeve ekzistuese dhe të mundshme dhe mekanizmat e asistencës së Palëve në përmbushjen të detyrimeve të tyre sipas Konventës (neni 26.5).

8. Vendos më tej se Grupi i Punës Ndërqeveritar i Pakufizuar do të vëzhgojë përgatitjet për sesionin e parë të Konferencës së Palëve dhe t'i raportojë asaj në mënyrë të drejtpërdrejtë;

9. Vendos se vendimet e marra nga Organi Negociues Ndërqeveritar në lidhje me Konventën mbi kontrollin e duhanit në kuadrin e Organizatës Botërore të Shëndetit, për pjesëmarrjen e organizatave joqeveritare, do të zbatohen për aktivitetet e Grupit të Punës Ndërqeveritar të Pakufizuar;

10.I kërkon Drejtorit të Përgjithshëm:

1) të sigurojë funksionet e sekretariatit sipas Konventës derisa të caktohet dhe krijohet koha e përshtatshme e sekretariatit të përhershëm;

2) të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar mbështetje ndaj shteteve anëtare, në veçanti për vendet e zhvilluara dhe vendet me ekonomi në tranzicion, në përgatitje për hyrjen në fuqi të Konventës;

3) të organizojë, sa më shpesh që të jetë e mundur, midis 16 qershorit 2003 dhe sesionit të Parë të Konferencës së Palëve, takime të një Grupi Pune Ndërqeveritar të Pakufizuar;

4) të vazhdojë të sigurojë se Organizata Botërore e Shëndetit luan një rol kryesor në sigurimin e këshillimit teknik, drejtimit dhe mbështetjes për kontrollin global të duhanit;

5) ta mbajë të informuar Asamblenë e Shëndetit në lidhje me progresin e bërë drejt hyrjes në fuqi të Konventës dhe të përgatitjeve që po bëhen për sesionin e parë të Konferencës së Palëve.

L I G J

Nr. 9475, datë 9.2.2006

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9367, DATË 7.4.2005 “PËR PARANDALIMIN E KONFLIKTIT TË INTERESAVE NË USHTRIMIN E FUNKSIONEVE PUBLIKE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 1 e nenit 12 shfuqizohet.

Neni 2

Në nenin 14 bëhen këto ndryshime:

1. Në fund të pikës 1 shtohen fjalët “edhe nivelet drejtuese në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave”.
2. Pas pikës 1 shtohet pika 1/1 me këtë përmbajtje:
“1/1. Deklarimi para fillimit të punës dhe ai pas largimit nga funksioni janë raste të veçanta të deklarimit periodik.”.
3. Pika 2 shfuqizohet.
4. Në pikën 3, fjalët “sipas gjendjes familjare, të përcaktuar në certifikatë për periudhën e deklarimit” shfuqizohen.
5. Fjalja e fundit e pikës 5 shfuqizohet.

Neni 3

Në nenin 15 bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 5, fjalia hyrëse ndryshohet si më poshtë:
“Zyrtarët që fillojnë punë për herë të parë në njërin nga funksionet që mbartin detyrimin për deklarim periodik, deklarojnë vetëm:”.
2. Në pikën 6 rreshti i katërt hiqen fjalët “në datën e largimit nga funksioni”.
3. Në fund të pikës 7 shtohet paragrafi si më poshtë:
“Deklarimi para fillimit të punës dorëzohet jo më vonë se 30 ditë nga data e fillimit të detyrës.”.

Neni 4

Neni 16 shfuqizohet.

Neni 5

Neni 19 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 19

Lidhja ndërmjet dy sistemeve dhe e drejta e informimit

1. Deklarimet e interesave, sipas seksioneve 1 e 2 të këtij kreu dhe çdo dokument tjetër, që i shoqëron ato, janë dokumente zyrtare. Të dhënat, që përftohen nga deklarimi, sipas këtij ligji, janë të lejueshme për publikun, në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.
2. Sistemet, rast për rast dhe periodike, të identifikimit e të regjistrimit të interesave, ndërtohen në forma e me mjete të tilla, që ndihmojnë njëri-tjetrin për:
 - a) parandalimin sa më të frytshëm të konfliktit të interesave;
 - b) mundësinë për informim, sa më të plotë e më të lehtë, të publikut me të dhënat e regjistruara të interesave.”.

Neni 6

Pikat 1, 2 e 3 të nenit 21 ndryshohen si më poshtë:

- “1. Asnjë individ nuk mund të lidhë kontratë me asnjë institucion publik, kur ky individ njësohet me një zyrtar në njërin nga funksionet e përcaktuara në kreun III seksioni 2 të këtij ligji, ose me asnjë shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri e thjeshtë, ku ky zyrtar zotëron, në mënyrë aktive apo pasive, aksione a pjesë në kapital, në çfarëdo sasive. Përjashtohen nga zbatimi i kësaj dispozite:

a) zyrtarët e nivelit të mesëm a të ulët drejtues, specialistët, gjyqtarët e prokurorët në nivelin e gjykatës së shkallës së parë e në atë të apelit;

b) zyrtarët e njësisve të qeverisjes vendore, të cilët, për këtë ndalim, trajtohen sipas pikës 2 të këtij neni.

2. Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, sipas interpretimit të këtij termi në ligjet përkatëse, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie.

3. Pavarësisht përcaktimeve të bëra në pikat 1 e 2 të këtij neni, ndalohet lidhja e kontratave ndërmjet një institucioni publik apo çdo institucioni publik tjetër të varësisë, nga njëra anë dhe një individ, personi fizik a juridik apo ndonjë formë tjetër ortakërie, nga ana tjetër, kur plotësohen, njëkohësisht, kushtet e mëposhtme:

a) zyrtari, që ushtron funksionet në këtë institucion publik ka kompetencë thelbësore dhe përcaktuese në vendimmarrjen e procesit të vlerësimit të ofruesve dhe të ofertave apo në përcaktimin e termave të kontratës;

b) ky zyrtar ka një interes privat, sipas përcaktimeve të nenit 37 të Kodit të Procedurave Administrative, apo të nenit 709 të Kodit Civil, ose ka një interes të llojit të përcaktuar në pikat 1 e 2 të këtij neni.”.

Neni 7

Në pikën 1 të nenit 24, fjalët “në nenin 21 pikat 1, 2 e 6” zëvendësohen me fjalët “në nenin 21 pikat 1 e 2”.

Neni 8

Pika 2 e nenit 25 ndryshohet si më poshtë:

“2. Ndalimi i lidhjes së kontratave, sipas çdo rasti të përcaktuar në nenin 21 të këtij ligji, zbatohet edhe në rastin kur zotërimi i aksioneve ose i pjesëve në kapital lidhet me një shoqëri tregtare, ortakëri a shoqëri të thjeshtë, e cila zotëron aksione apo pjesë në kapital të një shoqërie tregtare, ortakërie ose shoqërie tjetër të thjeshtë, kur kjo e fundit shfaqet si palë në lidhjen e një kontrate.”.

Neni 9

Në nenin 28, në shkronjën “b” hiqen fjalët “të avokatisë”, “ekspertit të licencuar”, “të konsulentit”.

Neni 10

Në nenin 33, fjalët “nuk mund të zotërojnë aksione në mënyrë aktive ose pjesë në kapital” zëvendësohen me fjalët “nuk mund të zotërojnë, në mënyrë aktive, aksione ose pjesë në kapital”.

Neni 11

Shkronja “b” e pikës 4 të nenit 35 ndryshohet si më poshtë:

“b) veprimtaria dhe/ose disa veprimtari tregtare së bashku të një personi të lidhur krijojnë një të ardhur të përgjithshme bruto vjetore, që nuk tejkalon kufirin prej 10 milionë lekësh.”.

Neni 12

Në pikën 2 të nenit 40 fjalët “me pikat 1, 2 e 3 të nenit 21 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “me pikat 1, 2, 3 e 6 të nenit 21 dhe pikën 3 të nenit 24 të këtij ligji”.

Neni 13

Në nenin 42 bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në pikën 2, fjalët “ nxjerr akte nënligjore në formën e urdhrave dhe të udhëzimeve” zëvendësohen me fjalët “nxjerr urdhra, udhëzime me karakter shpjegues dhe akte të tjera administrative, në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative”.

2. Në pikën 3, pas fjalisë së dytë shtohet fjalia me këtë përmbajtje: “Ato i paraqesin Inspektoratit të Lartë çdo vit për vitin pararendës, por jo më vonë se data 31 janar, një raport për veprimtarinë e kryer në zbatim të këtij ligji, përfshirë rastet e konflikteve të interesave, mënyrat e ndjekura për parandalimin ose trajtimin e tyre, rezultatet e arritura, si dhe çështjet e lidhura me deklarinimin periodik.”

3. Në pikën 4, fjalët “sipas kuptimit të ligjit të sipërpërmendur” zëvendësohen me fjalët “sipas ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 “Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”,”.

Neni 14

Në shkronjën “ç” të pikës 1 të nenit 44, fjalët “për shkelje të nenit 21 pikat 1, 2 e 3, nenit 22, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 pika 4 të këtij ligji” zëvendësohen me fjalët “për shkelje të nenit 21 pikat 1, 2, 3 e 6, nenit 22, nenit 23 pika 1 dhe nenit 24 pika 3 të këtij ligji”.

Neni 15

Neni 46 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 46

Nxjerrja e akteve nënligjore

1. Çdo institucion publik, në zbatim të këtij ligji, në mbështetje të parimit të proporcionalitetit dhe të natyrës së veçantë të funksioneve të institucioneve publike dhe /ose të çdo zyrtari, nxjerr një rregullore të brendshme për:

a) kuptimin e vendimmarrjes për një akt dhe të kompetencës thelbësore e përcaktuese të një zyrtari, sipas parimeve të përcaktuara në pikën 2 të nenit 4 të këtij ligji;

b) nënlojet e interesave ose interesat konkretë, që mund të bëhen shkak për lindjen e konfliktit të interesave;

c) kriteret dhe treguesit për matshmërinë dhe vlerësimin sa më të qartë e objektiv të kryerjes, në mënyrë të drejtë dhe/ose të padrejtë, të detyrave e të përgjegjësive nga një zyrtar, për parandalimin e konfliktit të interesave;

ç) procesin e identifikimit dhe të regjistrimit të interesave privatë të zyrtarëve, të lidhur me konfliktin, rast pas rasti, të interesit, sipas kreut II seksioni 1 të këtij ligji;

d) zbatimin e nenit 20 për mbrojtjen e të dhënave;

dh) mënyrat e trajtimit dhe të zgjidhjes së konfliktit të interesave, të përcaktuara në kreun IV të këtij ligji;

e) detyrat e veçanta, mënyrën e kryerjes së tyre dhe formën organizative të autoritetit e të strukturës përgjegjëse për zbatimin e këtij ligji, sipas nenit 41;

ë) vlerësimin e shkeljeve disiplinore dhe marrjen e masave ndëshkuese, sipas nenit 45 të këtij ligji.

2. Mungesa e akteve të mësipërme nuk përbën pengesë për zbatimin e këtij ligji. Në mungesë të akteve, ky ligj zbatohet drejtpërdrejt. Bën përjashtim vetëm deklarimi periodik i interesave, që kryhet në bazë të urdhrave dhe të udhëzimeve shpjeguese, të nxjerra nga Inspektori i Përgjithshëm.”.

Neni 16

Në nenin 49 pika 2, në fund të paragrafit, fjalët “shkronjën “b”” zëvendësohen me fjalët “shkronjën “c””.

Neni 17

Në nenin 50 shtohet një paragraf i dytë me këtë përmbajtje:

“Neni 3 pika 1 shkronja “ë”, neni 4 fjalët “në inspektoratet e ulëta”, neni 6, neni 9, neni 17 shkronjat “c” dhe “d”, nenet 24, 26 dhe 27 fjalët “dhe ai i ulët”, neni 28, në nenet 29, 30, 32 dhe 39 pika 2 fjalët “kryetarit të inspektoratit të ulët”, “ose të inspektorateve të ulëta”, “ose inspektoratit të ulët” të ligjit nr.9049, datë 10.4.2003 shfuqizohen”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.4797, datë 3.3.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë Alfred Moisiu

VENDIM

Nr. 124, datë 2.3.2006

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.337, DATË 15.7.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMISIONIT QEVERITAR PËR PROBLEMET UJORE ME VENDET FQINJE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 4, dhe 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.337, datë 15.7.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar të bëhen këto ndryshime:

1. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Komisioni kryesohet nga zëvendësministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ka në përbërje 9 përfaqësues nga:

- Ministria e Punëve të Jashtme
- Ministria e Brendshme
- Ministria e Financave

anëtar,
anëtar,
anëtar,

- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës anëtar,
- Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit anëtar,
- Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit anëtar,
- Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave anëtar,
- Akademia e Shkencave anëtar,
- Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit anëtar.”.

2. Pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“7. Shpenzimet për zhvillimin e veprimtarisë së komisionit dhe të nënkomisioneve (pagesat, transporti, dietat), të përballohen nga buxheti i ministrive dhe institucioneve përkatëse.”.

3. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 125, datë 2.3.2006

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.775, DATË 28.10.1996 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË UJIT”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 2, dhe 72 të ligjit nr.8093, datë 21.3.1996 “Për rezervat ujore”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 2 e vendimit nr.775, datë 28.10.1996 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Këshilli Kombëtar i Ujit (KKU) përbëhet nga 8 anëtarë, përkatësisht:

- Kryeministri kryetar,
- Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave zëvendëskryetar,
- Ministri i Brendshëm anëtar,
- Ministri i Financave anëtar,
- Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës anëtar,
- Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit anëtar,
- Ministri i Shëndetësisë anëtar,
- Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit anëtar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 126, datë 2.3.2006

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.228, DATË 23.4.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLIMIN E VEPRIMTARISË ME JASHTË TË
ADMINISTRATËS SHTETËRORE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 5 të ligjit nr.9095, datë 3.7.2003 “Për shërbimin e jashtëm të Republikës së Shqipërisë“, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.228, datë 23.4.2004 të Këshillit të Ministrave të bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 6 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Këto rregulla zbatohen edhe për vizitat zyrtare dhe private të zëvendësministrave, jashtë shtetit, të miratuara, paraprakisht, nga ministri përkatës.”.
2. Kudo në vendim, pas emërimit “...ministrat...” shtohet emërtimi “...zëvendësministrat...”
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 127, datë 2.3.2006

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.335, DATË 23.6.2000 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR RREGULLAT E PROKURIMIT PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 5 të ligjit nr.7971, datë 26.7.1995 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.335, datë 23.6.2000 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto shtesa:

1. Pas shkronjës “d” të pikës 5, shtohet shkronja “dh”, me këtë përmbajtje:
“dh. Për procedurat ndërkombëtare për blerjen e mallit, energji elektrike, jo më pak se 20 ditë. Në rast përsëritjeje të procedurës, ky afat të jetë jo më pak se 10 ditë.”.
2. Në pikën 6 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Për mallin energji elektrike, kushti i sigurimit të ofertës të jetë 2-5 për qind e vlerës së ofertës së paraqitur nga ofertuesi. Në rast se ofertuesi paraqet disa oferta alternative, kushti i sigurimit të ofertës të jetë 2-5 për qind të vlerës së ofertës më të madhe, të paraqitur nga ofertuesi.”.
3. Pas paragrafit të parë të pikës 8, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Në procedurat për prokurimin e mallit, energji elektrike, pjesëmarrësi i shpallur fitues duhet t’i deklarojë entit prokurues, nëpërmjet nënshkrimit të formularit të kontratës, gatishmërinë për të lidhur kontratën, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit.”.

4. Në fund të pikës 10 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:
“Në procedurat e prokurimit për mallin energji elektrike, enti prokurues është i detyruar të bëjë shpalljen e fituesit në Buletinin e Prokurimit Publik, por kontrata mund të lidhet edhe përpara botimit të emrit të fituesit në këtë buletin.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 129, datë 2.3.2006

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR.205, DATË 13.3.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E DISPOZITAVE ZBATUESE TË KODIT DOGANOR”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 123.2 të ligjit nr.8449, datë 27.1.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë“, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.205, datë 13.3.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar në fund të pikës 247.1 të bëhet shtesa, si më poshtë vijon:

“Kushti për të pasur një “nevojë reale ekonomike” quhet i plotësuar në njërin prej rasteve të mëposhtme:

a) Mallrat, të cilat kërkohen të vihen në regjimin e magazinës doganore, shërbejnë si burime alternative të energjisë dhe që, për vetë specifikat e transportit, ruajtjes, tregtimit, vëllimit e vlerës së tyre, e kanë të domosdoshme vendosjen në një regjim të magazinimit doganor. Futja e të tilla mallrave në territorin e Republikës së Shqipërisë kryhet vetëm nga persona juridikë, të licencuar nga autoritetet përkatëse dhe kërkesa e tyre, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penalitete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Në këto mallra përfshihen nafta dhe nënproduktet e saj, si edhe gazi natyror.

b) Mallrat, të cilat kërkohet të vihen në regjimin e magazinës doganore, janë mjete të papërdorura, vetëlëvizëse, që futen në territorin e Republikës së Shqipërisë nga importues të autorizuar nga prodhuesit a distributorët e këtyre mjeteve dhe që, për vetë numrin e madh të copëve në një dërgesë, për sipërfaqen e madhe, që zënë gjatë parkimit, për kohën e gjatë të shitjes së mjeteve dhe për vlerën e madhe të dërgesës, e kanë të domosdoshme vendosjen në një regjim të magazinimit doganor. Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penalitete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. Në këto mallra përfshihen autoveturat, kamionçinat, furgonët, mikrobusët dhe autobusët.

c) Mallrat, të cilat kërkohet të vendosen në regjimin e magazinës doganore, janë mallra, që u nënshtrohen njërit apo disa prej proceseve të mëposhtme:

- ambalazhim apo çambalazhim:
- vendosjes së etiketave, vulave, markave apo shenjave të ngjashme, me kusht që të mos bëjnë që mallrat të duken me origjinë të ndryshme nga origjina e tyre e vërtetë;
- montim apo bashkim i pjesëve, deri në masën që ato të paraqesin një element shtesë dhe jothelbësor në fabrikimin e mallit.

Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

ç) Mallrat, të cilat kërkohet të vendosen në regjimin e magazinës doganore janë mallra që, pasi u nënshtrohen një apo më shumë operacioneve, të përshkruara në shkronjën “c” të këtij vendimi, destinohen për shpërndarje të mëtejshme në tregjet rajonale, jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe kur këto mallra nuk janë vendosur në regjimin transit. Kërkesa e aplikuesit, për të fituar një autorizim të magazinës doganore, vlerësohet vetëm në rast se historiku i përmbushjes dhe shlyerjes së detyrimeve, tatimore e doganore, nuk përmban shkelje, shmangie, fshehje, penaltete dhe ndëshkime të tjera, në lidhje me zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi.

d) Në çdo rast, dhënia e autorizimit duhet të shoqërohet me mbulimin me garanci bankare, në masën e përcaktuar në aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi.

dh) Shërbimi doganor detyrohet që, për çdo autorizim për magazinë doganore, të miratuar, të instalojë falas *soft-ware* kompjuterike, me modulet përkatëse. Të gjitha lëvizjet e mallrave dhe të dokumenteve shoqëruese të pasqyrohen nga subjekti, nëpërmjet sistemit kompjuterik.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Fletorja Zyrtare gjendet:

- duke u abonuar pranë njësive postare të qyteteve ose
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot"
- Për informacione më të hollësishme mund të kontaktoni në numrat e telefonit:
04 255 563 ose 04 267 468

BOTIMET E TJERA TË QENDRËS SË PUBLIKIMEVE:

- 1. REGJISTRAT E NOTERISË, sipas formatit të miratuar nga Ministria e Drejtësisë.**
- 2. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË dhe të gjitha kodet e legjislacionit shqiptar.**
- 3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI të përditësuara për:**

1. PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë dhe vëllimi i II-të).....	1500
4. TAKSAT DHE TATIMET (suplement 2006).....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT.....	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT.....	2000

DOLI NGA SHTYPI:

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT.....	500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 9.3.2006

Tirazhi: 4000 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja "Mësonjëtorja"
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë